



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

Tel: 038/200 438 14

---

**KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG**

---

**P R O C E S V E R B A L**

Nga mbledhja e 3<sup>-të</sup> e Legjislacionit të VI<sup>-të</sup> të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 12.02.2018, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                          |                            |
|--------------------------|----------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK;     | 13. Ardita Idrizaj, AAK;   |
| 2. Enver Rugova, LDK;    | 14. Jehonë Haxhijaj, AAK;  |
| 3. Zenel Shatri, LDK;    | 15. Arben Kabashi, PDK;    |
| 4. Besa Ferati, LDK;     | 16. Lulzim Shoshi, PDK;    |
| 5. Naim Behlulaj, LDK;   | 17. Ajshe Metaj, PDK;      |
| 6. Luljeta Zeqiraj, LDK; | 18. Mirushe Sadikaj, PDK;  |
| 7. Haki Podrimaj, LDK;   | 19. Agron Avdijaj, VV;     |
| 8. Lulzim Blakaj, LDK;   | 20. Lavdije Bujupaj, VV;   |
| 9. Hajrush Shoshi, LDK;  | 21. Arif Elshani, AE;      |
| 10. Valbona Demaj, LDK;  | 22. Radoš Repanović, SL;   |
| 11. Edona Lubeniqi, LDK; | 23. Radenko Belošević, RB; |
| 12. Eliot Kukiqi, AAK;   | 24. Slaviša Maliković, SM. |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Kryetari i Komunës z. Haki Rugova, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

## **R e n d   d i t e**

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
3. Marrja e vendimit për formimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë e Financa;
4. Marrja e vendimit për formimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete.

**Kuvendi i Komunës më votim unanim pa asnjë votë kundër dhe abstenime vendosi:**

**Miratohet rendi i ditës pa vërejtje.**

### **Shqyrtimi i pikës 1.**

Në mbledhje nuk ishin të pranishëm: Naim Imeraj, Nexhmedin Balaj dhe Muhamet Ukaj, nga radhët e AAK-së.

### **Shqyrtimi i pikës 2.**

U shqyrtuan procesverbalet nga mbledhjet e kaluara të kuvendit (të gjithë anëtarëve të kuvendit iu është shpërndarë procesverbali nga mbledhja e kaluar dhe e njëjta gjendet në dosje: “shembulli 3”).

Arif Elshani - IQ, kreken fjalën, lexoi fjalinë e Kryetarit nga procesverbali të pika e fundit për zgjedhjen e zëvendës kryesuesit për komitete.

Po ashtu citon edhe nenin nga Ligji për vetëqeverisje lokale ku ceket përqindja minimale e komiteteve prej 10% zgjedhjen të zëvendës kryesuesit të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, ne kemi kërkuar na MAPL-ja në sqarim lidhur me këtë pikë dhe presim përgjigje na ta.

Kryetari i Komunës, përshëndet të gjithë të pranishmit, dhe thotë se është e vërtet ajo që kamë thënë, thekson që nëse është vullnet i Kuvendit ta ketë një zëvendës kryesuese nuk është shkelje, nëse është shkelje aj vendim nuk merret dhe nuk do të prodhojë efekt juridik.

**Pasi që nuk pati vërejtje në procesverbal, Kuvendi i Komunës më votim unanim pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime vendosi:**

**Miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar pa vërejtje**

**Në procedurën e votimit nuk ishin të pranishëm: Naim Imeraj, Nexhmedin Balaj dhe Muhamet Ukaj.**

### **Shqyrtimi i pikës 3.**

Shqyrtohet çështja e formimin të Komitetit për Politikë e Financa.

Kryesuesi, fillimisht njoftoi se sipas Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ Komiteti për Politikë e Financa mund të ketë përbërjen prej shtatë anëtarësh dhe jo me shumë se kaq, dhe sqaron përbërjen sipas këtij Udhëzimit.

Agron Avdijaj –VV, propozoj që komitet të ketë përbërjen prej 9 (nëntë) anëtarësh.

Kryesuesi, sqaronë nenin 7 i cili e përcakton me numër të anëtarëve të KPF-së në Udhëzimin Administrativ 03/2014 i cili është i nënshkruar nga ministri, ky komitet përbëhet prej shtatë anëtarëve. -----

Arif Elshani – QI, kërkon që të lexohet kërkesa e bërë nga VV dhe IQ që kanë formuar grupin e përbashkët dhe kërkojnë që Agron Avdijaj të hy në KPF nga ky grup.

Kryesuesi , lexon kërkesën e sapo marrë nga VV dhe IQ për njoftimin e formimit të grupit të përbashkët të tyre.

Arif Elshani-IQ, ne kërkon që Agron Avdijaj të hy në KPF nga ky grup, thotë që ligji e lejon por udhëzimet duhet të shikohen pasi që janë dy Udhëzime Administrative.

Agron Avdijaj-VV, beson që kjo duhet të jetë edhe në harmoni me ligjin sepse neni 52 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale, të gjitha partitit duhet të kenë nga një përfaqësuese.

Enver Rugova-LDK, përshëndet të gjithë të pranishmit, cekë që edhe në mandatin e kaluar ka pasur këso piripetive të keqkuptimit të Udhëzimeve Administrative. Thotë së kuvendë jemi që të gjithë të përfshihen në komitete vetëm të presim që kjo të jetë e përfshirë me ligj pasi që kemi qen në një trajnim dhe aty është diskutuar kjo qeshje e ndërrimit të udhëzimeve. i lutë anëtarët e kuvendit që ti bëjmë funksionale komitetet sipas formulës shkojnë 3 anëtar nga LDK, 2 anëtar nga AAK dhe 1 anëtar nga PDK.

-----  
Kryesusi, propozon që KPF-ja të përmbaj 3 anëtar LDK 2 AAK dhe 1 PDK

Arif Elshani -IQ, kërkon që kërkesën e tij që si grup të jen pjese e KPF-së me një përfaqësues.

Propozimi i Arif Elshanit hedhet në votim ,  
**Për janë 6 kundër 14 nuk miratohet.**

Arif Elshanit, lëshon mbledhjen.

Enver Rugova- LDK, Sqaron përqindjen siç i takojnë partive politike përfaqësuesit në KPF.

Agron Avdija - VV, thotë së e kupton kalkulimin e bërë nga Enveri por këtu mund të marrim edhe vullnet politik. Kërkon se a ka vullnet politik të kalohet pasi që mendova se nuk shkelnin ligjin por ky qenka draft që e kemi, mbesim që ta shohim si do të jetë udhëzimi i saktë administrativ. Nuk mendon që është shkelje e ligjit nëse Komiteti të ketë përbërjen prej 9 anëtarëve.

Kryetari, Thekson se mbi shtat anëtar nuk na lejon udhëzimi administrativ, por nëse vendosen që të jete prej 9 anëtarësh të jetë përfaqësuesi nga grupi juaj dhe një nga komitetet, sipas kalkulimeve kemi me përqindje si e ka përbërjen ky komitet.

Lulzim Shoshi- PDK, Përsëendet të gjithë të pranishmit, thotë së kryetari mundohet të jetë me fleksibil me të gjithë partitë e përfaqësuar, i referohet mandatit të kaluar së e njëjta gjë ka qene përfaqsimi i njëjte, thekson që ka pasur një lëvizje të anëtarit të Kuvendit nga AAK në VV dhe aj anëtar është larguar nga Komiteti me kërkesën e partisë nga e cila është larguar dhe ka bërë zëvendësimin me anëtarin nga AAK-ja. Edhe mbështetin ligjin që Komiteti të jetë prej 7 anëtarëve.

Enver Rugova - LDK, thekson që duhet ta respektojmë ligjin për Barazi gjinore jemi të obliguar.

Kryesuesi, hedh në votim, Propozimin që në bazë të përqindjes së votave siç e thotë edhe Udhëzimi të bëhet renditja në këtë mënyre 3 anëtar nga LDK, 2 anëtar nga AAK dhe 1 anëtar nga PDK.

**Kuvendi komunal më 20 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime vendosi:  
Oë KPF-ja të ketë këtë përbërje prej 7 anëtarëve, 3 anëtar nga LDK, 2 anëtar nga AAK dhe 1 anëtar nga PDK,  
Miraton me shumicë votash.**

Kryesuesi, lutë ti japin emrat nëse janë të gatshëm , nëse nuk i kanë emrat e gatshëm mese largu deri nesër ti dërgoni emrat në sekretari, po ashtu i lutë që të respektohet kota gjinore.

Enver Rugova, LDK nuk është e gatshme por nesër do të ju sjell emrat.

Arben Kabashi, edhe PDK do të sjell emrat nesër.

Eliot Kukiqi – AAK, do të sjellë nesër emrat.

- Në procedurën e votimit nuk ishin të pranishëm: Naim Imeraj, Nexhmedin Balaj dhe Muhamet Ukaj nga AAK si dhe Arif Elshani IQ.

**Shqyrtimi i pikës 4.**

Marrja e vendimit për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi, njoftoi se sipas ligjit dhe Udhëzimit Administrativ 03/2014 se ky komitet mund të ketë përbërjen prej pesë deri në nëntë anëtar. Dhe informon së në mandatin e kaluar ky komitet ka pasur përbërjen nga 5 anëtar 3 nga Kuvendi dhe 2 nga shoqëria civile kjo përbërje e ka përfaqësuar Komitetin për Komunitete

Hedh në votim që Komiteti për Komunitete të ketë përbërjen nga 5 anëtar.

Enver Rugova- LDK, uron që ky komitet të jetë funksional pasi që mandatin e kaluar nuk ka qenë i tillë, tani të mbaj mbledhje të rregullta të respektoj planin e punës të këtë propozime të funksionaj ashtu siç duhet, nga kuvendi janë 3 anëtar 1 nga LDK, nga AAK dhe 1 nga komunitetet dhe 2 nga shoqëria civile.

Radosh Repanoviq-SI, thotë se mandatin e kaluar kanë qenë 5 anëtar të Komitetit për Komuniteti por nga Kuvendi kanë qenë dy komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, sqarona së në mandatin e kaluar kanë qenë dy komunitete nga kuvendi sepse kemi pasur një Serb dhe një Boshnjake nga komunitetet dhe kanë qenë të dytë në komitet.

Radosh Repanoviq-SL, thotë se në ketë komitet duhet të ketë më shumë serb.

**Kuvendi Komunal Voton propozimi që Komiteti për Komunitete të ketë përbërjen prej 5 anëtarësh nga kuvendi 3 dhe nga shoqëria civile 2, nga Kuvendi 1 Serb, 1 nga LDK, 1 nga AAK dhe 2 tjerë nga shoqëria civile.**

**Miratohet me shumicë votash kjo përbërje**

Radosh Repanoviq-SL, Propozon që ky komitet të ketë 7 anëtar ashtu siç KPF.

Kryetari i Komunës, thekson që nëse nuk ka shkelje ligjore dhe nëse kuvendi ka vullnet mund të ketë edhe ky komitet shtatë anëtar, si ta shihni të arsyeshme ju jen anëtar të Kuvendit dhe mund të vendosni vetë.

Lulzim Shoshi-PDK, nëse kryetari thotë të rriten në shtatë përbërja e këtij komiteti nga Serbet të shkojnë dy, dhe automatikisht edhe ne si parti na takon një përfaqësuese në këtë komitet.

Kryetari i Komunës, pasi mundësia asgjë nuk ju ndalon që ketë komitet ta keni prej shtatë anëtarësh nëse ju dëshironi.

Agron Avdijaj –VV, thotë se pasi një herë u votua përbërja e këtij komiteti a kemi të drejtë ta ndryshojmë.

Nëse ky komitet parashihet të rritet me shumë e she të udhës të ketë nga komitetet tjera se sa nga Serbet, pore nuk është kundër që të rritet numri i përfaqësuesve në komitet.

Mirushe Sadikaj – PDK, thotë që ta respektojmë ligjin ashtu siç thotë mos të bëhet anashkalim në disa komunitete e në disa jo mos ti jepet orientim etnik, të shikohet përqindja e popullsisë.

Zenel Shatri-LDK, kërkon që në mënyrë ligjore të na tregohet nga zyrtarja ligjore se a ka shkelje procedurash këtu një sqarim.

Zekije Sutaj- Udhëheqës e Zyrës Ligjore, sqaron rreth procesit të votimit, sipas ligjit duhet që të shfuqizohet kjo përbërje me procedurat e votimit dhe të votohet përbërja tjetër sipas procedurave.

Kryesuesi i Kuvendit, hedh në votim kush është që të anulohet votimi që komiteti të ketë përbërjen prej 5 anëtarësh.

**Kuvendi komunal më 15 vota për, 4 kundër dhe 3 abstenime vendosi:  
Anulohet votimi që komiteti të ketë përbërjen prej 5 anëtarësh.**

Hedh në votim që Komiteti për Komunitete të ketë përbërjen prej 7 anëtarësh.

**Kuvendi komunal me 15 vota për, 4 kundër dhe abstenim 3 vendosi:  
Miratohet Komiteti për Komunitet të ketë përbëhet prej 7 /shtatë/ anëtarëve.**

Arben Kabashi –PDK, propozon që ky komitet ti ketë 2 Serbë, 1 Boshnjak, 1 Egjiptian, 1 anëtar nga LDK, 1 anëtar nga AAK dhe 1 anëtar nga PDK.

Enver Rugova – ne pajtohemi me këtë përbërje të propozuar nga Arbeni.

Kryesuesi i Kuvendit, hedh në votim propozimin e Arben Kabashit,

**Kuvendi komunal me 16 vota për, 2 kundër dhe 3 abstenime vendosi:  
Miratohet që komiteti për Komunitete të ketë këtë përbërje, 2 Serbë, 1 Boshnjak, 1 Egjiptian, 1 anëtar nga LDK, 1 anëtar nga AAK dhe 1 anëtar nga PDK.**

Emrat të dërgohen nesër.

Radosh Repanoviq-SL, propozon nga Serbet të jenë Radenko Belošević, RB; dhe Slaviša Maliković, SM.

Pasi që nuk pati diskutime të tjera, Kryesuesi shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:30.

Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj

6

Procesverbali



Kryesues,  
Qaush Balaj